



# **STATUTI I PARTISË ALEANCA KOSOVA E RE (AKR)**

**Prishtinë, Prill, 2017**

# **KAPITULLI I**

## **DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME**

### **Neni 1**

#### **Emri dhe misioni**

1. Emri zyrtar i partisë është: “Aleanca Kosova e Re”.
2. Shkurtesa e partisë “Aleanca Kosova e Re” është AKR.
3. AKR, është Parti Politike me orientim liberal-demokratik të qendrës, e cila është themeluar dhe vepron mbi bazën e programit të saj politiko- ekonomik dhe zgjedhor.
4. AKR ka për mision realizimin e programit të saj politik dhe ekonomik të cilin do ta përditësojë, sipas nevojave të qytetarëve të Republikës së Kosovës.
5. AKR është anëtare e asociacioneve dhe grupimeve politike ndërkombëtare me orientim të njëjtë programor siç janë, Aleanca Liberale Demokratike Europiane (ALDE) dhe Forumi i të rinjëve LYMEC.
6. AKR është e hapur dhe synon të bashkëpunojë me të gjitha partitë, asociacionet dhe organizatat e ngjashme që kanë orientim të njëjtë politik dhe programor.

### **Neni 2**

#### **Simbolet, llogoja dhe vulat**

1. AKR ka logon, simbolet dhe vulat e saj.
2. Forma, përmbajtja dhe modalitetet tjera të llogos dhe simboleve rregullohen me vendim të veçantë të presidentit të AKR.
3. AKR ka dhe vulat e saj. AKR i ka dy vula të rrumbullakëta. Vula e madhe e rrumbullakët përmban tekstin e emërimit të plotë, ndërsa vula e vogël e rrumbullakët përmban tekstin e shkurtër të AKR-së.
4. Degët e AKR-së e kanë vulën e vet të rrumbullakët me tekstin në formë rrethore “Aleanca Kosova e Re” dhe tekstin në mes “Dega XY”.
5. AKR-ja i ka dy vula katërkëndëshe, vulën katërkëndëshe për dërgesën e shkresave zyrtare dhe vulën katërkëndëshe për pranimin e shkresave zyrtare.

6. Përmbajtja, ruajtja, mënyra e përdorimit dhe forma e vulave mund të ndryshohet me vendim të kryesisë qëndrore të AKR.

### **Neni 3**

#### **Selia dhe statusi juridik**

1. Selia e AKR-së është në Prishtinë, sipas adreses: rruga e “UÇK” nr. 55/R Prishtinë.
2. Selia e AKR-së, me vendim të kryesisë, mund të caktohet në një vend tjetër.
3. AKR ka edhe ëeb faqen e saj, e cila është <http://akr-ks.com/>; emailin zyrtar i cili është: \_\_\_\_\_ dhe telefonin zyrtar i cili është: \_\_\_\_\_
4. AKR ka faqën e saj në rrjetin social FACEBOOK e cila është: <https://ëëë.facebook.com/aleancakosovaere/?fref=ts>.
5. AKR është subjekt juridik i regjistruar në evidencën e partive politike, e cila vepron në përputhje me kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

### **Neni 4**

#### **Vlerat**

1. AKR angazhohet dhe punon në funksion të shtetit të së drejtës; të ndërtojë shoqëri liberal-demokratike dhe të paqes, të zhvillimit shoqëror-ekonomik, të mirëqenies sociale, të lirisë, barazisë shoqërore dhe të prosperitetit ekonomik, shoqëror dhe politik.
2. AKR angazhohet dhe punon për të ndërtuar një shtet të së drejtës ku sundon ligji, të respektojë liritë dhe të drejtat e qytetarëve, si dhe ato fetare, në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe aktet ndërkombëtare.
3. AKR angazhohet të mbrojë dhe promovojë liritë dhe të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, në pajtim me kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare.

### **Neni 5**

#### **Qëllimi politik**

1. AKR ka për qëllim konkurimin nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe demokratike, dhe duke respektuar të drejtën e votës së lirë dhe parimet e tjera demokratike të drejtojnë qeverinë dhe institucionet e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të programit të saj politik dhe ekonomik.
2. Përmes zgjedhjeve të lira, AKR ka për qëllim të realizoj programin e saj politiko-ekonomik, në të mirë të qytetarëve dhe Republikës së Kosovës.

## **Neni 6**

### **Parimi i decentralizimit**

1. AKR është parti e cila vepron në bazë të parimit të decentralizimit dhe ka shtrirje territoriale në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Parimi i decentralizimit nga pika 1 e këtij neni jetësohet përmes organizimit të AKR-së në nëndegë dhe degë, në të gjitha komunat e Kosovës dhe vendbanime të tjera komunale.

## **Neni 7**

### **Parimet e organizimit të brendshëm**

1. AKR është e organizuar në bazë të parimit të demokracisë së brendshme, konkurrencës së lirë, transparencës, kundër nepotizmit dhe punës ekipore.
2. Parimi i demokracisë së brendshme jetësohet në bazë të së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur të secilit anëtarë të AKR, ndërsa parimet e tjera jetësohen përmes dispozitave të këtij statuti dhe akteve të tjera të AKR.
3. AKR është e hapur për të gjithë ata të cilët dëshirojnë të realizojnë vizionin e tyre politik, në përputhje me platformën dhe programin e AKR. AKR është e hapur dhe transparente në raport me publikun e gjërë brenda dhe jashtë Kosovës.
4. AKR respekton dhe mbron mendimin e të gjithë anëtarëve të saj. Vendimet e shumicës janë të obligueshme për të gjithë antarët e AKR.

## **Neni 8**

### **Aktet e brendshme**

1. Organizimi i AKR bazohet në kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.
2. Organizimi i brendshëm i AKR është i bazuar në aktet e brendshme të saj, të cilat miratohen nga organet kompetente, sipas procedurave të parapara në këtë statut dhe në aktet e tjera.
3. Akti më i lartë në organizimin e brendshëm të AKR është statuti. Të gjitha aktet e tjera që nxjerren nga organet kompetente të AKR duhet të jenë në përputhje me statutin e saj.
4. Për organizimin e brendshëm të saj AKR nxjerr edhe rregullore, të cilat në hierarkinë e akteve të brendshme renditen pas statutit të AKR.

5. Aktet e tjera të brendshme të cilat i nxjerr AKR janë: Vendimet, udhëzimet, rekomandimet dhe rezolutat.

6. Rregulloret dhe vendimet kanë efekt ekzekutiv kurse udhëzimet, rekomandimet dhe rezolutat kanë efekt këshilldhënës.

## **Neni 9**

### **Aktivitetet jo politike**

1. AKR përveq aktiviteteve politike organizon edhe aktivitete të tjera me karakter jo politik në përputhje me ligjet në fuqi si: veprimtari shoqërore, klube, institute, konferenca, tubime intelektuale, konferenca shkencore, forume të ndryshme, aktivitete humanitare etj.

2. Të gjitha aktivitetet jo politike të AKR janë publike dhe gjithpërfshirëse.

## **KAPITULLI II**

### **ANËTARËSIA E AKR**

## **Neni 10**

### **Dispozitat e përgjithshme**

1. AKR është e hapur për anëtarësim për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët kanë mbushur moshën 16 vjeçare. AKR respekton antarësimin vullnetar të të gjithë atyre të cilët dëshirojnë t'i bashkangjiten vizionit dhe programit të saj qeverisës.

## **Neni 11**

### **Kushtet e anëtarësimit**

1. Për të fituar statusin e anëtarit të AKR duhen plotësuar këto kushte:

I. Secili i anëtarësuar duhet të ketë mbushur moshën 16 vjeçare,

II. Të mos jetë anëtar i ndonjë organizate tjetër e cila është në kundërshtim me rendin juridik të Republikës së Kosovës si dhe me vizionin e AKR.

2. Në AKR mund të anëtarësohen edhe anëtarë të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, vizioni dhe orientimi i të cilëve përputhet me programin dhe vizionin qeverisës të AKR.

3. Anëtari i AKR duhet të mbrojë dhe të promovojë vizionin dhe politikat e AKR në të gjitha aktivitetet publike dhe politike brenda dhe jashtë Kosovës.

## **Neni 12**

### **Procedura e anëtarësimit**

1. Të gjithë të interesuarit për anëtarësim, duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë formularin për anëtarësim, në nëndegën më të afërt ose përmes platformës online të AKR, e cila gjendet në ëeb faqen e saj.
2. Të gjithë anëtarët/et e rinjë regjistrohen në librin e anëtarësisë si dhe në databazën e të dhënave të AKR.
3. Secili anëtarë/e i ri pajiset me kartelën e antarësisë dhe bëhet me automatizëm pjesë e strukturave të nëndegës më të afërt të AKR, sipas vendbanimit të tij/saj.
4. Anëtarësimi i antarëve të rinjë mund të bëhet edhe në secilën nga zyrat e AKR në territorin e Republikës së Kosovës.
5. Secili anëtarë/e ka të drejtë të jetë pjesë e organeve lokale dhe qëndore të AKR.

## **Neni 13**

### **Të drejtat dhe detyrimet e anëtarit/es**

Secili anëtar/e i AKR ka këto të drejta dhe obligime:

1. Të marrë pjesë në përcaktimin dhe në realizimin e politikës partiake përmes angazhimit individual dhe grupor;
2. Të ndër marrë nisma që janë në pajtim me Statutin dhe Programin e AKR dhe t'ua prezantojë organeve vendimmarrëse;
3. Të zgjedhë dhe të zgjedhet në organet e AKR-së;
4. Të promovojë punën e AKR-së dhe të shpërndajë vizionin dhe programin e saj tek elektorati dhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe jashtë saj.
5. Të jetë i informuar për punën e organeve të AKR;
6. Të marrë pjesë në aktivitetet përkatëse të AKR;
7. Të realizojë të drejtat dhe të përmbushë obligimet e tjera të parapara me Program, me Statut dhe me akte e vendime të tjera.

## **Neni 14**

### **Humbja e statusit të anëtarit/es**

1. Statusi i anëtarit/es të AKR mund të humbet:

- a. Me dorëheqje
  - b. Me vdekje;
  - c. Në rast të largimit me vendim të organeve të AKR-së;
  - d. Me anëtarësimin si dhe kandidimin në një parti tjetër të Republikës së Kosovës.
2. Dorëheqja nga antarësia i drejtohet organeve të AKR, duke filluar nga nëndega.
  3. Anëtarët/et e përjashtuar nga AKR kanë të drejtë ankese në kryesinë e AKR në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e nxjerrjes së vendimit për përjashtim.

### **Neni 15**

#### **Mbështetësit jo anëtarë**

1. AKR përveç anëtarëve ka edhe mbështetësit dhe simpatizantët të cilët nuk janë të anëtarësuar në AKR. Mbështetësit e AKR që nuk janë anëtarë të saj mund të marrin pjesë në takimet publike dhe jo publike të AKR me ftesën e organeve kompetente si dhe përmes thirrjes masive.
2. Të gjithë mbështetësit e AKR që pajtohen me programin dhe vizionin e saj mund të kandidohen edhe në listat zgjedhore të AKR, me vendim të organeve kompetente.

## **KAPUTULLI III**

### **ORGANIZIMI I AKR**

#### **Neni 16**

##### **Organet, mandati dhe kompetencat**

1. AKR ka organet qendrore dhe jo qendrore.
2. Organet e AKR janë të organizuara dhe punojnë sipas statutit, rregulloreve dhe akteve të brendshme duke u bazuar në parimet që mundësojnë një vendimarrje demokratike dhe punë transparente.
3. Mandati i secilit organ të AKR është katër (4) vite.
4. Në përbërjen e tyre organet e AKR respektojnë standardet e barazisë gjinore.

5. Organet e AKR mund të shkarkohen në procedura të njëjta, sikur ato të emrimit të tyre, në përjashtim të rasteve që rregullohen me këtë statut.

### **Neni 17**

#### **Organet jo qendrore**

1. Organet jo qendrore të AKR janë:
  - a. Nendega
  - b. Dega

### **Neni 18**

#### **Organet qendrore**

1. Organet qendrore të AKR janë:
  - a. Kongresi i pergjithshem;
  - b. Kuvendi;
  - c. Kryesia;
  - d. Presidenti;

### **Neni 19**

#### **Nendega, organet dhe organizimi i saj**

1. Nendega eshte baza e organizimit te AKR e cila eshte e lidhur me degët dhe konsiderohet e themeluar nese ne kuvendin e saj ka 21 anetarë.
2. Organet e nendegës janë:
  - I. Kuvendi i nendegës;
  - II. Kryesia e nendegës;
  - III. Kryetari i nendegës;
4. Secili anetar i ri i AKR me automatizem behet pjesë e kuvendit te nendegës.
5. Kryetarin dhe kryesinë e nendegës e zgjedh kuvendi i nendegës, me vota te fshehta.



6. Lista e anëtarëve të kryesisë së nëndegës propozohet nga kandidati për kryetar i nëndegës dhe zgjedhet nga kuvendi i nëndegës me shumicën e votave.
7. Nëse kryesia e nëndegës nuk merr shumicën, procedura e zgjedhjes së saj përsëritet dy herë radhazi, nëse zgjedhja e kryesisë nuk mund të realizohet as në raundin e dytë duhet të propozohet një listë tjerë e anëtarëve të kryesisë së nëndegës.
8. Kryetari i nëndegës votohet në procedurë të ndarë nga kryesia e nëndegës.
9. Në përputhje me pikën 1 të këtij neni kuvendi i nëndegës ka së paku 21 anëtarë, kurse kryesia e nëndegës së paku 5 anëtarë.
10. Përjashtim nga numri i anëtarëve nga pika 9 e këtij neni bëjnë nëdegët e vogla, përbërjen e të cilave e përcakton numri i kufizuar i banorëve në një lokalitet.
11. Kryesia e nëndegës është kompetente për të vendosur për komunikimin me anëtarë të partisë, organizimin në teren të anëtarësisë së nëndegës dhe komunikimin me degë.
12. Kryesia e nëndegës udhëheqet nga kryetari i nëndegës.

## **Neni 20**

### **Dega**

1. Dega është forma më e lartë e organizimit të AKR në nivel jo qendror. Një degë mund të përbëhet nga disa nëndegë, varësisht nga përbërja demografike dhe shtrirja territoriale.
2. Dega e AKR përbëhet nga dy osë më tepër nëndegë, si dhe është e organizuar në bazë të parimeve demokratike të përcaktuara me kushtetutë, ligje dhe statutin e AKR.
3. Organ kompetent për themelimin e degës së re është kryesisa dhe presidenti i AKR.
4. Dega është përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin në nëndegëve dhe mban kontakte të vazhdueshme me to.
5. Organet e degës janë:
  - I. Konventa zgjedhore e degës;
  - II. Kuvendi i degës;
  - III. Kryesia e degës;
  - IV. Kryetari i degës;

- V. Koordinator i degës. Nëse në një komunë ka më shumë se një degë, kryesia qendrore së bashku me presidentin e AKR emërojnë një koordinator/e, i cili ka përgjegjësi për koordinimin dhe harmonizimin e politikave të degëve ndërmjet vete si dhe të degëve me organet qendrore të AKR-së.

## **Neni 21**

### **Konventa zgjedhore e degës**

1. Konventa zgjedhore e degës është organ zgjedhor, e cila mbahet çdo katër (4) vite dhe ka funksion zgjedhor.
2. Pjesë e konventës së degës janë të gjithë anëtarët e kuvendëve të nëndegëve përkatëse dhe organeve të tjera jo qendrore. Numri maksimal i anëtarëve të konventës zgjedhore të degës nuk është i kufizuar.
3. Konventa zgjedhore e degës zgjedh kryetarin dhe kuvendin e degës.
4. Konventa zgjedhore e degës zgjedh kryesinë e punës së saj e udhëheqet nga kryetari i saj apo anëtari më i vjetër. Kryesia e punës i cakton rregullat e mbarëvajtjes së punës të konventës zgjedhore me vendim të veçantë.
5. Votimi në konventën zgjedhore të degës është i fshehtë.
6. Në rastin e zgjedhjes së kryetarit të degës, nëse në garë ka vetëm një kandidat për kryetar votimi bëhet në mënyrë të hapur me aklamacion.

## **Neni 22**

### **Kuvendi i degës**

1. Kuvendi i degës është organ përfaqësues jo qendror i degës, i cili funksionon si organ legjitim, në mes të konventës zgjedhore dhe organeve të tjera të degës.
2. Në kuvendin e degës, sipas detyrës zyrtare marrin pjesë kryetari i degës, katër (4) përfaqësues/e nga forumi rinor i AKR si dhe katër (4) përfaqësues nga forumi i gruas së AKR, nga dega përkatëse.
3. Nëse në momentin e konstituimit të kuvendit të degës, për shkaqe objektive nuk ka përfaqësues/e të forumit rinor të AKR-së dhe përfaqësuese të forumit të Grueas së AKR,

vendet e tyre rezervohen deri në plotësimin e plotë, sipas përbërjes në paragrafin 2 të këtij neni.

4. Kuvendi i degës në përbërjen e tij ka deri në 71 delegatë.

5. Delegatët nga pika 4 zgjedhen nga konventa zgjedhore e degës, me propozimin e nëndegëve përkatëse. Numri i përfaqësimit në kuvendin e degës varet nga numri i anëtarësisë në degë dhe nëndegë.

6. Anëtarët e kuvendit të degës konsiderohen të zgjedhur nëse marrin shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në konventën zgjedhore të degës.

7. Përjashtim nga përbërja e kuvendit të degës nga pika 4 bëjnë degët të cilët kanë numër të vogël të anëtarësisë, për shkak të përbërjes demografike. Në këto raste kuvendi i degës konsiderohet i themeluar nëse në degën përkatëse janë tri (3) nëndegë.

8. Kuvendi i degës ka këto kompetenca:

- I. Zgjedh kryesinë e degës pas propozimit të kryetarit;
- II. Zgjedh sekretarin e degës;
- III. Miraton rregullore dhe akte të tjera për organizimin e degës;
- IV. Së bashku me kryesinë dhe kryetarin e degës organizon punën dhe funksionimin e degës;
- V. Kryen punë të tjera të nevojshme për funksionimin e degës.

8. Kuvendi i degës ka kryetarin e saj i cili kryeson mbledhjet e kuvendit të degës. Mbledhjet e kuvendit të degës mund t'i thërrasin edhe 1/3 e anëtarëve të saj. Kryetari i kuvendit të degës zgjedhet me mandat katër (4) vjeçar.

9. Kryetarin/en e kuvendit të degës e zgjedh kuvendi i degës nga radhët e tij, me propozimin e 1/3 së anëtarëve.

10. Organizimi dhe procedurat e tjera të kuvendit të degës rregullohen me akt të veçantë.

## **Neni 23**

### **Kryetari dhe nënkryetarët e degës**

1. Kryetari i degës zgjedhet dhe shkarkohet nga konventa zgjedhore e degës, me shumicën e votave.

2. Dega ka dy nënkryetarë të cilët zgjedhen me vendim nga kryetari i degës. Mandati i nënkryetarëve të degës përfundon së bashku me mandatin e kryetarit.

3. Kryetari i degës ka këto kompetenca:

- I. Përfaqëson anëtarësinë e AKR në territorin përkatës në të cilin shtrihet dega;
- II. Thërret dhe drejton mbledhjet e kryesisë së degës;
- III. Është përgjegjës për zbatimin e politikave të përgjithshme të AKR në nivel të degës, për të cilat këshillohet me presidentin e AKR dhe koordinatorin e degëve;
- IV. Është përgjegjës për mbarëvajtjen e punëve dhe sukseset e AKR në territorin përkatës;
- V. Në koordinim me kryesinë e degës të mbajë aktive degën, duke mbajtur aktivitete, organizime, forume, tryeza edhe jashtë aktiviteteve të fushatës zgjedhore;
- VI. Kryen punë tjera të parapara me rregullore dhe akte tjera.

## **Neni 24**

### **Kryesia e degës**

1. Kryesia e degës, së bashku me kryetarin dhe kuvendin e degës udhëheq punën e AKR në degë.

2. Kryesia e degës ka këto kompetenca:

- I. Mobilizmin e strukturave të degës,
- II. Organizimin e aktiviteteve partiake të degës,
- III. Organizimin e procesit zgjedhor në degën përkatëse,
- IV. Një herë në vit i raporton kuvendit të degës për mbarëvajtjen e punëve të degës, përmes një raporti me shkrim.

3. Kryesia e degës ka më së shumti 21 anëtarë. Me qëllim të hapjes dhe krijimit të hapësirës kadrovike, për kuadrot e reja, kryesia e degës mund të kërkojë nga kryesia qendrore rritjen e numrit të anëtarëve të kryesisë së degës.

4. Pjesë e kryesisë së degës sipas detyrës zyrtare janë kryetari/ja e forumit rinor dhe e forumit të gruas së AKR si dhe nënkryetarët e degës.

5. Dy anëtarë/e të kryesisë së degës i cakton Presidenti i AKR me vendim të veçantë.

6. Anëtarët e tjerë të kryesisë së degës, sipas pikës 3 zgjedhen nga kuvendi i degës, pas propozimit të kryetarit të degës, me shumicë të votave.

7. Anëtari i kryesisë konsiderohet i zgjedhur nëse merr shumicën e votave të anëtarëve prezent të kuvendit të degës. Nëse kuvendi i degës dështon në zgjedhjen e ndonjërit/es anëtarë/e të kryesisë së degës, procedura përsëritet në dy raunde dhe nëse edhe në raundin e dytë nuk mund të zgjedhet ndonjëri nga anëtarët/et e propozuar, procedura përsëritet, pas propozimit të kandidatëve të rinjë.

8. Nëse për ndonjërin nga anëtarët e zgjedhur të kryesisë, pas raundit të dytë të votimit, ka kundërshtime që ndikojnë në kompaktësinë e strukturës së AKR ai/ajo zëvendësohet me vendim të kryetarit të degës.

## **Neni 25**

### **Sekretari i degës**

1. Me qëllim të organizimit sa më të mirë, efikasitetit të punës dhe mbështetjes së degës, secila degë e AKR, sipas nevojave ka sekretarin e saj.

2. Sekretari i degës zgjedhet nga kuvendi i degës me mandat katër (4) vjeçar.

3. Kompetencat e sekretarit të degës janë të natyrës organizative dhe caktohen me akt të veçantë që e nxjerr sekretari qëndror i AKR.

4. Për punën e tij, sekretari i degës i raporton sekretarit qëndror të AKR dy herë në vit.

## **Neni 26**

### **Raportimi për punën në degë dhe situatat e veçanta**

1. Kryetari i degës i raporton Presidentit të AKR për mbarvajtjen e punëve në degë çdo gjashtë (6) muaj përmes një raporti me shkrim.

2. Kryesia e degës i raporton Kryesisë qëndrore të AKR për mbarvajtjen e punëve në degë përmes një raporti me shkrim çdo gjashtë (6) muaj.

3. Në rast të komplikimit të punës në degë si dhe mosmarrëveshjeve në mes të anëtarësisë, kryetarit dhe organeve të tjera, sipas dispozitave të këtij statuti dhe akteve të tjera, për zgjidhjen e konflikteve eventuale ndërhyjnë Presidenti i AKR.

4. Vendimi i Presidentit të AKR për zgjidhjen e situatave sipas paragrafit 3 të këtij neni është përfundimtar dhe i obligueshëm për të gjitha organet e AKR.

## **Neni 27**

## **Administrata në degë**

1. Duke marrë parasysh mundësitë financiare dhe me qëllim të efikasitetit në punë AKR themelon edhe administratën e degës.
2. Mënyra e funksionimit të administratës së degës rregullohet me akt të veçantë i cili miratohet nga kryesia e degës.
3. Administrata e degës udhëheqet nga sekretari i degës së AKR.

## **Neni 28**

### **Degët e AKR jashtë vendit**

1. AKR ka degët e saj jashtë Republikës së Kosovës.
2. Për themelimin e degëve të reja jashtë Republikës së Kosovës, sipas vlerësimit të situatës vendos Kryesia dhe Presidenti i AKR.
3. Mënyra e funksionimit dhe procesi zgjedhor në degët e AKR jashtë Kosovës rregullohet me akt të veçantë që nxjerret nga Kryesia e AKR.

## **Neni 29**

### **Organet qendrore të AKR**

#### **Kongresi i përgjithshëm dhe përbërja e tij**

1. Kongresi i përgjithshëm është organi më i lartë qendror i AKR.
2. Kongresi i përgjithshëm mbahet në sesione të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
3. Sesioni i rregullt i kongresit të përgjithshëm mund të jetë sesion pune dhe sesion zgjedhor.
4. Sesioni i punës së kongresit të përgjithshëm mund të mbahet tre herë brenda një mandati, vërejtisht nga nevoja, ndërsa sesioni zgjedhor çdo katër (4) vite.
5. Sesionin zgjedhor të kongresit të përgjithshëm e thërret presidenti, kryesia, kuvendi i AKR si dhe 2/3 e anëtarëve të kongresit të përgjithshëm.
6. Kongresin e përgjithshëm e përbëjnë:
  - I. Delegatët e zgjedhur nga dega. Pjesëmarrja e degëve në kongresin e përgjithshëm është proporcionale dhe varet nga numri i banorëve në degën përkatëse. Mënyra e përfaqësimit të delegatëve të degës në kongresin e përgjithshëm është e rregulluar me aneksin I, i cili është pjesë përbërëse e këtij statuti.

- II. Anëtarët e kryesisë së AKR;
- III. Anëtarët e kuvendit të AKR;
- IV. Ministrat dhe deputetët nga AKR;
- V. Kryesia e forumit rinor dhe forumit të gruas;
- VI. Kryetari/ja e forumit rinor, pjesë e kryetarit kolegjial në mandat dhe kryetarja e forumit të gruas;
- VII. Kryetarët e komunave nga radhët e AKR;
- VIII. Anëtarët e kuvendeve komunale nga radhët e AKR;
- IX. Kabineti i presidentit;
- X. Anëtarët e nderit, të cilët caktohen nga ana e presidentit të AKR.

7. Mënyra e përfaqësimit të degëve në konventën e përgjithshme caktohet me akt të veçantë të cilin e nxjerr kryesia e AKR.

8. Mandati i delegatëve të kongresit të përgjithshëm është 4 vite. Delegatët përfaqësues të degës, në çdo kohë mund të zëvendësohen nga dega. Për zëvendësimin e tyre njoftohet koordinatori i degëve dhe presidenti i AKR.

### **Neni 30**

#### **Mënyra e punës së kongresit të përgjithshëm në takimet e rregullta**

1. Puna e kongresit të përgjithshëm rregullohet me akt të brendshëm që e nxjerr kryesia e AKR.
2. Për mbajtjen e kongresit të përgjithshëm delegatët e kongresit njoftohen 15 ditë përpara.
3. Rendin e ditës së kongresit e përpilon kryesia e AKR-së së bashku me presidentin.
4. Të gjithë organet jo qëndrore dhe qëndrore të AKR kanë të drejtë të propozojnë pika të rendit të ditës në takimet e kongresit të përgjithshëm. Pikat e rendit të ditës duhet të propozohen me shkrim, më së largu tri (3) ditë para takimit të kongresit të përgjithshëm. Në rast të mos rrespektimit të afatit prej tri (3) ditësh, pikat e rendit të ditës mund të bëhen pjesë e diskutimit vetëm me vendim të Presidentit të AKR.
5. Kongresi i përgjithshëm zhvillon punimet, nëse në takim marrin pjesë 51% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

6. Vendimet në takimet e kongresit të përgjithshëm merren me shumicën e votave.

### **Neni 31**

#### **Takimet e jashtëzakonshme të kongresit të përgjithshëm**

1. Takimet e jashtëzakonshme të kongresit mund të mbahen në çdo kohë. Takimet e jashtëzakonshme të kongresit mund të thirren nga:

- I. 1/2 e anëtarëve të kongresit të përgjithshëm;
- II. Kuvendi i AKR;
- III. Kryesia qendrore e AKR;
- IV. Presidenti i AKR.

2. Për mbajtjen e takimit të jashtëzakonshëm anëtarët e kongresit duhet të njoftohen pesë (5) ditë përpara.

3. Rendi i ditës në takimet e jashtëzakonshme caktohet sikur në takimet e rregullta të kongresit. Materialet i dërgohen anëtarëve të kongresit të jashtëzakonshëm dy (2) ditë përpara mbajtjes së takimit të jashtëzakonshëm.

### **Neni 32**

#### **Kompetencat e kongresit të përgjithshëm**

1. Kongresi i përgjithshëm i AKR ka këto kompetenca:

- I. Miraton rendin e ditës dhe rregullorën e punës;
- II. Zgjedh Presidentin e AKR;
- III. Miraton programin politik të AKR;
- IV. Miraton ndryshimet dhe plotësimet e statutit;
- V. Zgjedh anëtarët e kuvendit të AKR;
- VI. Miraton rezoluta dhe akte të tjera;

### **Neni 33**

#### **Presidenti i AKR**

1. Presidenti është organi individual i cili e përfaqëson unitetin e AKR-së dhe anëtarësinë e saj.



2. Presidenti është përfaqësues i AKR brenda dhe jashtë vendit.
3. Presidenti i AKR ka kompetenca ekzekutive në pajtim me këtë statut dhe aktet e tjera të AKR.
4. Presidenti i AKR zgjedhet drejtpërdrejt nga vota e anëtarëve të AKR-së, sipas parimit një anëtar një votë. Procedurat e zgjedhjes së presidentit rregullohen me udhëzues të veçantë.
5. Mandati i Presidentit të AKR është katër (4) vite.
6. Presidenti i AKR shkarkohet nga kongresi i përgjithshëm pas një procedure të vlerësimit, nëse ai/ajo ka bërë shkelje serioze të statutit të AKR-së.
7. Për punën e tij Presidenti i AKR i përgjigjet kongresit të përgjithshëm.
8. Në rast të mungesës së presidentit atë e zëvendëson njëri nga anëtarët e kabinetit të presidentit, me autorizim të veçantë të tij.

### **Neni 34**

#### **Kompetencat e presidentit**

1. Presidenti i AKR ka këto kompetenca:
  - I. Përfaqëson AKR brenda dhe jashtë;
  - II. Udhëheq punën e organeve të AKR;
  - III. Therret mbledhjen e kongresit, kuvendit drejtues dhe kryesisë së AKR;
  - IV. Jep propozime dhe vendos për zhvillimin e politikave të AKR;
  - V. Bën propozime për ndryshimin e statutit;
  - VI. Pas konsultimit të kryesisë vendos për propozimet e kandidatëve të AKR në listën për deputetë dhe ministra;
  - VII. Propozon anëtarët e kryesisë, kuvendit dhe kabinetit të presidentit;
  - VIII. Vendos për suspendimin e të gjithë atyre që veprojnë në kundërshtim me politikat e AKR;
  - IX. Ndërhyn dhe vendos për zgjidhjen e konflikteve në mes të organeve dhe çfarëdo konflikti tjetër i shfaqur në situata të caktuara;
  - X. Jep çmime, mirënjohje dhe medalje.

XI. Nxjerr vendime me karakter ekzekutiv, me qëllim të organizmit dhe funksionimit të AKR, në pajtim me kushtetutën, ligjet dhe statutin e AKR.

### **Neni 35**

#### **Kuvendi**

1. Kuvendi është organ i mesëm, i AKR dhe për nga numri i anëtarëve radhitet pas kongresit të përgjithshëm.
2. Kuvendi i AKR ka 199 anëtarë, të cilët zgjedhen nga degët në bazë të parimit të proporcionalitetit, sipas sqarimeve në aneksin I i cili është pjesë përbërese e këtij statuti. 1/4 e anëtarëve të kuvendit caktohen (kooptohen) nga ana e presidentit të AKR-së.
3. Numri i anëtarëve të Kuvendit varet nga numri i degëve. Degët që kanë numër më të madh të anëtarësisë kanë të drejtë të propozojnë numër më të madh të anëtarëve të Kuvendit, sipas aneksit I.
4. Lista e propozimeve për anëtarë të kuvendit të AKR dorëzohet nga secila degë para mbajtjes së sesionit zgjedhor të kongresit të përgjithshëm.
5. Konsiderohen të zgjedhur ata anëtarë të kuvendit të cilët marrin shumicën e votave të anëtarësisë të degës së tyre, përmes votimit të fshehtë.
6. Pjesë e kuvendit të AKR, sipas detyrës zyrtare janë edhe kryetarët e degëve, kryetarët e komunave, ministrat dhe deputetët e AKR si dhe anëtarët të cilët caktohen nga presidenti.
7. Anëtarët e kuvendit mund të humbin statusin e tyre si anëtarë të kuvendit drejtues:
  - I. Me vdekje,
  - II. Me dorëheqje,
  - III. Me përjashtim.
8. Anëtarët e kuvendit mund të zëvendësohen në të njëjtën procedurë të zgjedhjes.

### **Neni 36**

#### **Kompetencat e Kuvendit**

1. Kuvendi i AKR ka këto kompetenca:
  - I. Jep propozime për programin zgjedhor të AKR;

- II. Mund të jap propozime për kandidatët e AKR-së në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale;
- III. Zgjedh anëtarët e kryesisë së AKR, pas propozimit nga presidenti;
- IV. Mund të propozoj ndryshime në statut;
- V. Miraton rregulloren për organizimin e punës;
- VI. Kryen punë të tjera të parapara me statut;

### **Neni 37**

#### **Takimet e Kuvendit dhe zgjedhja e kryetarit**

1. Kuvendi mban takime të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
2. Takimet e rregullta të kuvendit mbahen katër (4) herë në vit.
3. Takimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme mund të thirren nga kryetari dhe 1/3 e anëtarëve.
4. Anëtarët e kuvendit, në mbledhjen e parë themeluese zgjedhin kryetarin e tyre nga radhët e anëtarëve, sipas një votimi të fshehtë. Kryetari i kuvendit konsiderohet i zgjedhur nëse merr shumicën e votave të anëtarëve prezent.
5. Të drejtën e propozimit të kandidatëve për kryetar të kuvendit e kanë secili anëtarë.
6. Kuvendi ka edhe ndihmëskryetarët e tij dhe sekretarin e kuvendit. Ndhimëskryetarët e kuvendit i zgjedh kryetari i kuvendit në mbledhjen themeluese të kuvendit të AKR-së.
7. Sekretarin e kuvendit e zgjedh kuvendi, pas propozimit nga ana e presidentit të AKR-së.
8. Për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit prezent duhet të jenë të paktën 51% e anëtarëve. Vendimet në takimet e kuvendit merren me shumicën e votave. Mbledhja e parë themeluese e kuvendit mbahet një (1) muaj pas mbajtjes së kongresit zgjedhor të AKR-së.
9. Në mbledhjen themeluese të tij, kuvendi i AKR zgjedh një komision, i cili menaxhon procesin zgjedhor të kryetarit, ndihmëskryetarëve dhe sekretarit që përbëhet nga tre (3) antarë. Ky komision udhëheq mbledhjen e parë themeluese të kuvendit të AKR-së.
10. Në mbledhjen e parë themeluese të kuvendit, konfirmohet lista e anëtarësisë së kuvendit të dërguara nga degët e AKR-së.

11. Në takimet e Kuvendit të AKR mund të marrin pjesë edhe deputetët, ministrat dhe anëtarët e Kryesisë së AKR, por pa të drejtë vote.

### **Neni 38**

#### **Kryesia qëndrore**

1. Kryesia qëndrore është organ i lartë, e cila së bashku me presidentin udhëheq politikat ekzekutive dhe menaxhuese të AKR.
2. Kryesia e AKR përbëhet prej 45 anëtarëve, 37 i zgjedh Kuvendi i AKR-së ndërsa 8 emërohen nga Presidenti i AKR. Pjesë e anëtarësisë së kryesisë sipas detyrës zyrtare është edhe Presidenti i AKR dhe dy anëtarë të kabinetit të presidentit të cilët i cakton presidenti.
3. Pjesë e kryesisë së AKR sipas detyrës zyrtare është edhe sekretari, kryetari/ja i forumit rinor dhe kyetarja e forumit të gruas të AKR.
4. Anëtarët e tjerë të kryesisë zgjedhen nga kuvendi me propozim të Presidentit të AKR, me votim, sipas një procedure që e organizon Kuvendi i AKR.
5. Mandati i anëtarëve të kryesisë është katër (4) vite.

### **Neni 39**

#### **Kompetencat e kryesisë qëndrore**

Kryesia qëndrore e AKR ka këto kompetenca:

- I. Së bashku me presidentin jep pëlqimin përfundimtar për listën e AKR për zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale.
- II. Monitoron dhe mbikëqyr degët dhe nëndegët në përmbushjen e obligimeve statutore.
- III. Së bashku me presidentin e AKR dhe jep pëlqimin për raportin përfundimtar financiar të AKR.
- IV. I jep propozime presidentit të AKR për zgjidhjen e krizave, në rast të situatave të jashtëzakonshme në degë.
- V. Së bashku me presidentin cakton kriteret e nominimit të kandidatëve të AKR në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale.
- VI. Zgjedh anëtarët e komisioneve të përhershme të AKR.

- VII. Së bashku me presidentin dhe kryesinë e ngushtë themelojnë institute dhe forume të tjera në kuadër të AKR.
- VIII. Kryen punë të tjera të parapara me statut.

#### **Neni 40**

##### **Takimet e kryesisë qëndore**

1. Kryesia mban takime të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
2. Takimet e rregullta të kryesisë mbahen dy (2) herë në muaj, ndërsa ato të jashtëzakonshme mbahen me kërkesën e 1/3 së anëtarëve dhe të Presidentit të AKR.
3. Mbledhjet e kryesisë udhëheqen nga Presidenti i AKR, ndërsa në rast mungese nga njëri prej zëvendësve të tij. Mbledhjet e rregullta të kryesisë i thërret presidenti.
4. Anëtarët e kryesisë për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta njoftohen dy (2) ditë përpara ndërsa për mbajtjen e mbledhjeve të jashtëzakonshme një (1) ditë përpara.
5. Për mbajtjen e mbledhjeve të kryesisë prezent duhet të jenë 51% të anëtarëve.
6. Vendimet e kryesisë merren me shumicën e votave.

### **KAPITULL IV**

#### **ORGANET E TJERA**

#### **Neni 41**

##### **Parimet e përgjithshme**

1. Përveç organeve ekzekutive, qëndore dhe jo qëndore, AKR ka edhe organet e tjera ndihmëse të cilët kanë fushëveprim këshilldhënës, edukativ dhe organizativ.
2. Organet e tjera të AKR-së janë:
  - I. Forumi rinor;
  - II. Forumi i gruas;
  - III. Sekretari i përgjithshëm AKR;
  - IV. Kabineti i presidentit;

- V. Zëvendësit/et e presidentit;
- VI. Kabineti qeverisës i AKR-së;
- VII. Komisionet;
- VIII. Shtabi zgjedhor i AKR;
- IX. Grupi për promovimin e vlerave të AKR;
- X. Akademia politike e AKR.

2. Mënyra e punës, organizimi, vendimmarrja dhe çështjet e tjera të organeve të AKR, sipas këtij neni organizohet me rregullore të veçantë.

3. AKR ka edhe grupin parlamentar të saj që përbëhet nga deputetët e AKR në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Anëtarët e grupit parlamentar të AKR janë të obliguar të respektojnë statutin e AKR, politikat dhe programin e saj qeverisës, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

4. Anëtarët e grupit parlamentar të cilët nuk respektojnë statutin, politika, vizionin dhe vendimet e AKR mund të përjashtohen nga AKR dhe organet e saj, sipas dispozitave të këtij statuti.

## **Neni 42**

### **Forumi rinor**

1. Forumi Rinor i AKR është organ në të cilin përfaqësohet rinia e AKR.
2. Forumi rinor si organ i të rinjëve është i organizuar në të gjitha degët e AKR, në bazë të parimit të decentralizimit.
3. Forumi rinor udhëheqet nga kryetari kolegjal i përbërë nga katër anëtarë, sipas parimit të rotacionit.
4. Secila degë e AKR ka kryetarët/et e forumit rinor në nivel të degës.
5. Forumi rinor në nivel të degës ka kongresin e përgjithshëm, i cili e zgjedh kryetarin/en e forumit rinor në këtë nivel.
5. Organi më i lartë i forumit rinor të AKR është kongresi i përgjithshëm qëndror i forumit rinor.
6. Kryetari kolegjal i forumit rinor, sipas pikës 3 të këtij neni në nivel të përgjithshëm zgjedhet nga kongresi i përgjithshëm i forumit rinor të AKR, në bazë të një liste të propozuar. Konsiderohen të zgjedhur të propozuarit që marrin shumicën e votave.

7. Forumi rinor i AKR ka kryesinë e tij dhe organet e tjera.
8. Në përputhje me këtë statut, në rast të konfliktëve dhe mosmarrëveshjeve në Forumin rinor të AKR, ndërhyt presidenti i AKR. Vendimi i tij në lidhje me situatat e jashtëzakonshme është përfundimtar.
9. Forumi rinor ka edhe sekretarin e tij.
10. Organizimi, kompetencat, procedurat e vendimarrjes, mënyra e anëtarësimit dhe aspekte të tjera të forumit rinor të AKR rregullohen me rregullore të veçantë e cila miratohet nga Kuvendi i AKR.

### **Neni 43**

#### **Forumit i gruas**

1. Forumit i Gruas së AKR, është i organizuar dhe funksionon sipas parimeve të njëjta sikurse forumit rinor.
2. Forumit i Gruas së AKR ka për qëllim të bashkojë dhe promovojë gratë dhe vajzat të cilat janë pjesë e strukturave të saj.
3. Forumit i gruas udhëheqet nga kryetarja në nivel qëndror. AKR ka edhe forumin e gruas në nivel të degës që udhëheqet nga kryetarja e saj.
4. Forumit i gruas udhëheqet nga kongresi i përgjithshëm në nivel qëndror.
5. Kryetarën e forumit të gruas e zgjedh kongresi i përgjithshëm i forumit të gruas.
6. Forumit i gruas ka edhe kryetarën e forumit në nivel të degës të cilën e zgjedh kongresi i forumit të gruas në degën përkatëse.
7. Të gjitha gratë dhe vajzat pjesë e strukturave të AKR do të jenë të përfaqësuara në institucionet e Republikës së Kosovës, sipas ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
8. Organizimi, kompetencat, procedurat e vendimarrjes, mënyra e anëtarësimit dhe aspekte të tjera të Forumit të Gruas së AKR rregullohen me rregullore të veçantë e cila miratohet nga Kuvendi i AKR.

### **Neni 44**

#### **Sekretari i përgjithshëm**

1. Sekretari i përgjithshëm i AKR është pozitë administrative-politike dhe kujdeset për organizimin dhe funksionimin e përditshëm të AKR.

2. Sekretari i përgjithshëm i AKR zgjedhet nga kryesia e AKR me propozimin e presidentit.

3. Kompetencat e sekretarit qendror janë:

- I. Organizon dhe udhëheq zyrën qendrore dhe administratën e AKR;
- II. Ndihmon dhe mbështet organet e AKR në punën administrative të tyre;
- III. Kujdeset dhe është përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve të organeve të AKR;
- IV. Kryen punë të tjera organizative sipas nevojës;
- V. Organizon dhe koordinon punën e degëve të AKR;
- VI. Mban kontakte dhe takime të rregullta me kryetarët e degëve;
- VII. Kryen edhe punë të tjera ad hoc të cilat i delegohen nga presidenti ose organet e tjera;

4. Organizimi dhe mënyra e punës së sekretarit të përgjithshëm rregullohet me vendim të veçantë të cilin e nxjerr kryesia e AKR.

## **Neni 45**

### **Kabineti i presidentit**

1. Kabineti i presidentit është organ këshillëdhënës i cili zgjedhet nga Presidenti i AKR, me vendim dhe vepron në koordinim me të. Ky organ ka për qëllim këshillimin e presidentit në lidhje me politikat e AKR.

2. Kabineti i presidentit përbëhet nga tetë (8) anëtarë dhe udhëheqet nga presidenti i AKR. Në rast të mugesës së tij ai udhëheqet nga ndonjëri prej anëtarëve të cakton presidenti i AKR.

3. Anëtarët e kabinetit të presidentit shërbejnë si këshilltarë të Presidentit të AKR nga fusha të ndryshme dhe janë mbikqyrës të departamentëve të caktuara, varësisht nga profilizimi i këtyre departamentëve.

4. Kabineti i presidentit menaxhon punën e AKR mbi baza ditore dhe së bashku me koordinatoren e degëve bëjnë vizita dhe kujdesen për strukturën dhe anëtarësinë e AKR.

5. Kabineti i presidentit mban takime të rregullta javore dhe merr vendime me shumicën e votave.



6. Përveç anëtarëve të kabinetit sipas këtij neni, sipas nevojës dhe vizionit të tij, presidenti i AKR cakton edhe anëtarë të tjerë për të qenë pjesë e këtij organi, përfshirë edhe shefin e stafit.

## **Neni 46**

### **Zëvendësit/et e presidentit**

1. Në rast të mungesës së tij, presidenti zëvendësohet nga zëvendësit/et e tij, të cilët caktohen nga presidenti me vendim të veçantë.
2. AKR ka tre (3) zëvendës/e president, të cilët caktohen sipas paragrafit 1 të këtij neni duke respektuar standardet e barazisë gjinore. Sipas nevojës presidenti i AKR-së cakton edhe dy (2) zëvendës/e me vendim të veçantë.
3. Zëvendësit/et e presidentit kryen punët të cilat i delegon presidenti me autorizim të veçantë.

## **Neni 47**

### **Kabineti Qeverisës i AKR-së**

1. Kabineti qeverisës i AKR-së është organ strategjik dhe politik i cili promovon dhe zhvillon programin qeverisës të AKR-së.
2. Kabineti qeverisës i AKR-së përbëhet nga dhjetë (10) anëtarë, të cilët zgjedhen nga kryesia e AKR-së, me propozim të presidentit.
3. Kabineti qeverisës i AKR-së funksionon në bazë të shtyllave të programit dhe të profileve qeverisëse të AKR-së. Secili antarë i këtij kabineti udhëheq një profil të qeverisjes, sipas programit të AKR-së, sipas zgjedhjes që e bën presidenti i AKR-së.
4. Kabineti qeverisës i AKR-së udhëheqet nga presidenti i AKR-së.
5. Kabineti i qeverisës i AKR-së ka sekretarin e tij, të cilin e cakton presidenti i AKR-së.
6. Mënyra e punës së kabinetit qeverisës të AKR-së rregullohet me vendim të veçantë i cili nxjerret nga ky organ.

## **Neni 48**

### **Departamentet dhe Komisionet**

1. Kryesia e AKR-së themelon (8) tetë Departamente në bazë të Propozimit të Presidentit të AKR-së. Secili Departament ka edhe nëndepartamentet e veta. Bartësit e Departamenteve dhe Nëndepartamenteve zgjidhen nga Kryesia e AKR-së në bazë të Propozimit të Presidentit të AKR-së.

2. Komisionet e AKR janë trupa të cilat ndihmojnë punën e përditshme të saj.
3. AKR ka komisionet e përhershme dhe ato ad hoc.
4. Komisionet e përhershme të AKR janë:
  - I. Komisioni për financa;
  - II. Komisioni statutor;
  - III. Komisioni disiplinor;
  - IV. Komisioni për ankesa;
5. Përbërja, organizimi, fushëveprimi, mënyra e punës dhe mënyra e marrjes së vendimeve të komisioneve rregullohet me rregullore të veçantë, e cila miratohet nga Kuvendi Drejtues i AKR.

## **Neni 49**

### **Shtabi zgjedhor**

1. Shtabi zgjedhor i AKR është organ i cili ka për qëllim koordinimin e aktiviteteve zgjedhore të AKR.
2. Shtabi zgjedhor vepron dhe themelohet në kohën e zgjedhjeve të përgjithshme dhe lokale.
3. Shtabi zgjedhor emërohet nga Kryesia e AKR në bashkëpunim me presidentin. Kryesuesin e shtabit zgjedhor e zgjedh presidenti i AKR.
4. Mënyra e punës së shtabit zgjedhor rregullohet me vendim të veçantë të cilin e nxjerr presidenti në bashkëpunim me kabinetin e tij.

## **Neni 50**

### **Grupi për promovimin e vlerave të AKR**

1. Grupi për promovimin e vlerave të AKR (GPV) është një grupim aktiv që funksionon në kuadër të AKR dhe ka për qëllim promovimin e vlerave qeverisëse dhe ideologjisë së AKR që buron nga programi dhe orientimi politik i AKR.
2. GPV ka koordinatorin e saj i cili emërohet nga Presidenti i AKR me vendim të veçantë.
3. GPV përbëhet kryesisht nga aktivistë të rinjë që kanë për qëllim masovizimin e AKR.
4. GPV ka këto kompetenca:

- I. Angazhohet për përhapjen e programit të AKR dhe promovimin e vlerave të saj;
  - II. Angazhohet për masovizimin e AKR dhe shtrirjen sa më të gjërë territoriale;
  - III. Angazhohet për rekrutimin e anëtarëve të rinjë;
  - IV. Angazhohet për identifikimin e votuesve të rinjë;
  - V. Angazhohet për krijimin e grupeve mobile gjatë zgjedhjeve;
  - VI. Bashkëpunon dhe i ndihmon forumet politike gjatë zgjedhjeve.
  - VII. Kryen punë të tjera të parapara me statut;
5. Aktiviteti dhe puna e GPV rregullohet me rregullore të veçantë e cila miratohet nga Kryesia e AKR.

## **Neni 51**

### **Akademia politike e AKR**

1. Akademia politike e AKR është organ profesional e cila vepron në kuadër të AKR.
2. Akademia politike e AKR ka për qëllim të edukojë votuesit e rinjë, me qëllim të vetëdijësimit politik dhe ngritjes së vetëdijës qytetare për një qeverisje të mirë.
3. Akademia politike e AKR organizon shkollën politike si dhe takime të tjera me komunitetet e ndryshme profesionale.
4. Shkolla politike e AKR organizohet dy herë në vit. Në kuadër të shkollës politike do të angazhohen profesorë vendor dhe ndërkombëtarë, në përputhje me modulet përkatëse.
5. Akademia politike e AKR është përgjegjëse për përgatitjen e strategjive dhe dokumenteve të ndryshme programore të AKR.
6. Akademia politike udhëheqet nga njerëz profesional të cilët nuk janë të angazhuar aktivisht në aktivitete politike.
7. Akademia politike e AKR udhëheqet nga drejtori të cilin e emëron presidenti me vendim të veçantë.
8. Aktiviteti, organizimi, fushëveprimi, misioni, puna dhe çështjet tjera të Akademisë politike dhe strukturave të saj rregullohet me rregullore të veçantë.

## **KAPITULL V**

## **DISPOZITAT E TJERA**

### **Neni 52**

#### **Parimet e procesit zgjedhor dhe përfaqësimit**

1. Zgjedhjet e organeve qëndore dhe jo qëndore dhe për organet e tjera zhvillohen sipas parimeve të transparencës, fshehtësisë së votës, barazisë, të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, etj.
2. Përfaqësimi në organet e AKR bazohet në parimin e proporcionalitetit. Në organet qëndrore degët janë të përfaqësuara sipas numrit të anëtarësisë.
3. Të gjitha çështjet që lidhen me procesin zgjedhor dhe përfaqësimin në AKR që nuk janë rregulluar me këtë statut rregullohen me akt të veçantë.

### **Neni 53**

#### **Financimi**

1. Financimi i AKR bazohet në legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe praktikatat ndërkombëtare.
2. Burimet e financimit bazohen në buxhetin e Republikës së Kosovës, donacione, projekte si, pagesën e anëtarësisë si dhe forma të tjera të përcaktuara me ligj.
3. Mënyra e detajizuar e financimit, raportimi dhe transparenca e financimit të AKR rregullohen me akt të veçantë e cila nxjerret nga kryesia në bashkëpunim me presidentin dhe kabinetin e Presidentit të AKR në përputhje me ligjin.

### **Neni 54**

#### **Informimi dhe transparenca**

1. AKR është e hapur për publikun e gjërë, mediat dhe shoqërinë civile.
2. Me qëllim të realizimit të parimit të transparencës AKR ofron mekanizma adekuat sipas këtij statuti.
3. AKR ka zëdhënësin/en, në nivel qëndor, të cilin e emëron Presidenti i AKR.
4. Zëdhënësi ka për qëllim informimin e mediave dhe publikut të gjërë dhe bashkëpunon ngushtë me faktorët relevant me qëllim të informimit.

5. AKR me qëllim të informimit lëshon komunikata për media si dhe mban konferenca të ndryshme.

6. AKR ka edhe zëdhënësit/et e saj në nivel lokal.

7. Mënyra e informimit dhe komunikimit me publikun i AKR rregullohet me akt të veçantë, i cili nxjerret nga Kryesia e AKR.

## **Neni 55**

### **Interpretimi i statutit**

1. Interpretimin përfundimtar të statutit të AKR e bën Komisioni statutar.
2. Përbërja e Komisionit statutar caktohet me rregulloren për Komisionin statutar.
3. Komisioni statutar zgjedhet me vendim nga presidenti i AKR dhe ka 3 anëtarë.

## **Neni 56**

### **Amendamenti i statutit**

1. Amendamenti i statutit bëhet nga Kongresi i përgjithshëm i AKR.
2. Secili amendament hyn në fuqi pasi të votohet me 2/3 e votave të anëtarëve të kongresit të përgjithëshëm.
3. Të drejtën për të propozuar amendamente statutare e kanë:
  - I. Presidenti;
  - II. 1/3 e anëtarëve të kongresit;
  - III. Kryesia e AKR;
  - IV. Kuvendi;
  - V. Komisioni statutar.

## **Neni 57**

### **Dispozitat kalimtare**

1. Riorganizimi dhe organet e reja të AKR duhet t'i përshtaten dispozitave të këtij statuti.
2. AKR themelon të gjitha organet e reja në bazë të këtij statuti.
3. AKR në afat prej një (1) muaj pas hyrjes në fuqi të statutit themelon një grup punues për hartimin e rregulloreve, me qëllim të zbatimit të këtij statuti.

## Neni 58

### Hyrja në fuqi

1. Ky statut hyn në fuqi pas miratimit nga ana e kongresit të përgjithshëm me shumicë prej 2/3 të votave.
2. Pas miratimit të këtij statuti do të nxjerren aktet e tjera të nevojshme për zbatimin e tij si dhe do të shfuqizohen të gjitha aktet e tjera që janë në kundërshtim me të.

**Prishtinë, Prill 2017**

**Behgjet Pacolli**

**President i AKR-së**

---

### **ANEKSI I**

Ky aneks rregullon mënyrën e përfaqësimit të delegatëve të degëve të AKR në kongresin e përgjithshëm sipas nenit 29.1 të Statutit (**Tabela 1**) dhe Kuvendin e AKR sipas nenit 35.2 të Statutit (**Tabela 2**). Ky aneks është pjesë e Statutit të AKR-së.

#### **Tabela 1-Përfaqësimi i degëve në kongresin e përgjithshëm të AKR**

1. Deçan-27	delegatë
2. Dragash-27	delegatë

3. Glogoc-27	delegatë
4. Gjilan-35	delegatë
5. Gjakova-35	delegatë
6. Istog-27	delegatë
7. Kaçanik-27	delegatë
8. Klinë-27	delegatë
9. Fushe Kosove-27	delegatë
10. Kamenicë-27	delegatë
11. Mitrovicë e Jugut-35	delegatë
12. Mitrovicë e Veriut-19	delegatë
13. Leposaviq-19	delegatë
14. Lipjan-31	delegatë
15. Novobërdë-15	delegatë
16. Obiliq-21	delegatë
17. Rahovec-31	delegatë
18. Pejë-35	delegatë
19. Podujevë-35	delegatë
20. Prizren-41	delegatë
21. Prishtinë-51	delegatë
22. Skenderaj-31	delegatë
23. Shtime-21	delegatë
24. Shtërpcë-15	delegatë
25. Suharekë-31	delegatë

26. Ferizaj-41	delegatë
27. Viti-27	delegatë
28. Vushtrri-35	delegatë
29. Zubin Potok-15	delegatë
30. Zveçan-15	delegatë
31. Malishevë-31	delegatë
32. Hani i Elezit-15	delegatë
33. Mamushë-15	delegatë
34. Junik -15	delegatë
35. Klokot-15	delegatë
36. Graçanicë-19	delegatë
37. Ranillug-15	delegatë
38. Partesh-15	delegatë

**Tabela 2-Përfaqësimi i degëve në kuvendin e AKR**

1.	Deçan-3	anëtarë
2.	Dragash-3	anëtarë
3.	Glogoc-3	anëtarë
4.	Gjilan-4	anëtarë
5.	Gjakova-4	anëtarë
6.	Istog-3	anëtarë



7.	Kaqanik-3	anëtarë
8.	Klinë-3	anëtarë
9.	Fushe Kosove-3	anëtarë
10.	Kamenicë-3	anëtarë
11.	Mitrovicë e Jugut-4	anëtarë
12.	Mitrovicë e veriut-2	anëtarë
13.	Leposaviq-2	anëtarë
14.	Lipjan-3	anëtarë
15.	Novobërdë-1	anëtarë
16.	Obiliq-2	anëtarë
17.	Rahovec-3	anëtarë
18.	Pejë-4	anëtarë
19.	Podujevë-4	anëtarë
20.	Prizren-5	anëtarë
21.	Prishtinë-5	anëtarë
22.	Skenderaj-3	anëtarë
23.	Shtime-2	anëtarë
24.	Shtërpcë-2	anëtarë
25.	Suharekë-3	anëtarë
26.	Ferizaj-5	anëtarë
27.	Viti-3	anëtarë
28.	Vushtrri-4	anëtarë
29.	Zubin Potok-2	anëtarë

30.	Zveçan-1	anëtarë
31.	Malishevë-3	anëtarë
32.	Hani i Elezit-2	anëtarë
33.	Mamushë-1	anëtarë
34.	Junik -2	anëtarë
35.	Kllokot-2	anëtarë
36.	Graçanicë-2	anëtarë
37.	Ranillug-1	anëtarë
38.	Partesh-1	anëtarë